


Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Në Kapitullin 4, klasa jonë do të punojë me numrat negativë. Do të mësojmë si të veprojmë me numra me shenjë negative në mbledhje, zbritje, shumëzime, pjesëtime, ngritje në fuqi dhe grafikë.

Do të përdorim vijën e numrave për të njehsuar shuma dhe diferenca që përmbajnë numra negativë. Për shembull, për të mbledhur $3 + (-2)$, do të vendosim në fillim një shenjë lart mbi numrin 3. Meqëse numri që do të mblidhet është negativ, shenjën do t'a kthejmë në drejtim negativ. Meqë jemi duke bërë një mbledhje, shigjetën do ta lëvizim pastaj në po atë drejtim nga është e kthyer, gjithsej 2 hapa, për të arritur rezultatin 1.

Përfundimi: 1 Fillimi: 3



Pasi të kemi mësuar si të mbledhim dhe të zbresim numra negativë, do të mësojmë si t'i shumëzojmë dhe të pjesëtojmë këta numra. Pastaj do të mësojmë si të bëjmë grafikë në katër kuadrantet dhe të gjejmë distancat midis pikave në një rrjet koordinatash. Gjithashtu do të hetojmë eksponentet, dhe do të përdorim makinat zgjatëse dhe tërheqëse për të kuptuar mënyrën si funksionojnë eksponentët negativë.

Fjalor Dy terma të rinj që do të ndeshim këtë kapitull:

formula e distancës

kuadrant

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Gjatë javëve të ardhshme, nxënësi mund të tregojë interes për mënyrën si përdoren numrat negativë në situata të ndryshme jashtëshkollore. Ndhimoheni të mendojë për raste përdorimi të zakonshëm të numrave negativë – si lartësia mbi nivelin e detit, borxhi kombëtar, temperaturat nën zero, ose llogaritë bankare nga ku janë tërhequr më shumë para se ç'kishte të depozituara.